



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 4  
Prishtinë, më 3 qershor 2021, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P r o c e s v e r b a l**

**i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haki Abazi, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Dimal Basha, Gazmend Gjyshinca, Ariana Musliu-Shoshi dhe Time Kadrijaj.

**Munguan:** Branislav Nikoliq, Fitore Pacolli-Dalipi, Kujtim Shala dhe Bahrim Shabani.

**Delegacioni nga Parlamenti i Austrisë:** z. Martin Engelberg, deputet, znj. Carmen Jeitler Cincelli, kryetare e Grupit të miqësisë Austri - Kosovë, z. Kevin Kaiser, përfaqësuesi i Grupit të miqësisë Austri-Kosovë dhe zëvendësambasadori i Austrisë në Kosovë, z. Martin Schaller.

**Nga Zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Lulzim Pllana, Ambasador i Republikës së Kosovës në Austri, Ermira Gashi, Genta Lepaja, Fatjeta Ibishi, Arbenita Mjekiqi, Festim Bytyçi-Kuvendi i Kosovës, Granit Bllaca-KDI dhe Haki Huruglica-MPJD.

**Mbledhjen e kryesoi:** Haki Abazi, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**Takim me delegacionin nga Parlamenti i Austrisë**

**Haki Abazi** i dëshiroi mirëseardhje delegacionit austriak në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për të cilën vizitë tha se është domethënëse dhe e guximshme në këtë fazë përfundimtare të përcjelljes së pandemisë. Z. Abazi njoftoi delegacionin se tani është një komision i ri pas zgjedhjeve parlamentare me një përfaqësim shumë partiak, me LVV që ka shumicën në parlament dhe partive të tjera, si PDK, LDK, AAK, LS dhe GM. Fryma që dëshirojmë ta kultivojmë në këtë komision është t'i rishikojmë qasjet tona ndaj punëve të jashtme dhe të diasporës. Diaspora jonë tha se është shumë e rëndësishme, është një nga mbështetësit tanë më të mëdhenj financiar, për të cilët duhet krijuar hapësirë që të vinë dhe të investojnë këtu. Mes tjerash z. Abazi tha se si institucionet e kosovare,

ashtu edhe partitë politike, pozita e opozita dhe shoqëria civile kemi dy ambicie specifike, anëtarësimin e Kosovës në BE dhe në NATO. Njoftoi se kemi barriera të mëdha të për të cilat është e nevojshme t'i ndërtojmë kapacitetet tona, e po ashtu barrierë tjetër tha se është përpjekja e Serbisë që t'ia vështirësojë Kosovës rrugëtimin drejt BE-së e NATO-së. Kjo nuk është diç e re ngase doktrina e Serbisë nuk ka ndryshuar që nga vrasja e Franc Ferdinandit. Ajo vazhdon ta luajë strategjinë e dominimit në Ballkanin Perëndimor, tha ai. Ne besojmë në partneritet dhe në marrëdhënie të avancuara të të drejtave të njeriut dhe avancimin e të ardhmes ekonomike, duke hapur potenciale në rajon, për t' u bërë më i zhvilluar. Serbia, tha se dëshiron ta mbajë peng Kosovën dhe ta fuqizojë rolin e saj në rajon. Kosova ka pasur mbështetjen në të gjitha fushat nga pala austriake, po ashtu i nevojitet mbështetja që të ndikojnë në Francën e Holandën për liberalizimin e vizave, sepse qytetarët tanë janë duke u mbajtur në burg në kolektiv, ata duhet të lëvizin lirshëm, ndërsa ne do të luftojmë korrupsionin dhe do t'i përmbushim detyrat tona, tha z. Abazi.

**Martin Engelberg**, falënderoi komisionin për organizimin e takimit duke theksuar se është shumë i impresionuar nga të gjithë, me të cilët është takuar. Ai tha se është e jashtëzakonshme të shohin se sa të orientuar drejt perëndimit janë të gjithë, e që në Evropën kontinentale nuk mund të shihen kaq politikan që janë të orientuar drejt integritimeve euroatlantike. Shprehu kënaqësinë që dëgjoji vlerësime nga deputetët për ndihmën që i ka ofruar Austria ndër vite Kosovës. Njoftoi se ministri i Jashtëm është shumë i interesuar që të mbështesë liberalizimin e vizave për Kosovë këtë e kanë në programin qeveritar tha ai dhe pyeti anëtarët e komisionit, se çfarë i ndalon të lëvizin në drejtimin e duhur për liberalizimin e vizave.

**Haki Abazi** theksoi se kemi sfida të mëdha nga 5 vendet që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës për çka duhet të angazhohemi që të njihemi nga këto shtete dhe të shkojmë drejt integritimit në BE. Do të ishte e pafalshme për ne, tha ai që ne të qëndrojmë në status quo, sepse për gjeneratat e politikanëve dhe liderëve në Evropë që e kanë parë gjenocidin, kujtimi emocional është duke u zbehur, prandaj është koha e fundit që ne të shkojmë drejt anëtarësimit në BE. Ndër prioritetet e tjera z. Abazi tha se është edhe anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, UNESCO e INTERPOL, si dhe të ndryshohet qasja ndaj diasporës, që tani e tutje potencialin e tyre ta shohim si investitor në Kosovë.

**Xhavit Haliti** falënderoi delegacionin për vizitën në Kosovë dhe theksoi se beson se falënderues janë edhe të gjithë kolegët për kontributin e Austrisë mike. Këtë takim si takim të parë me delegacione të huaja në këtë legjislaturë z. Haliti e konsideroi domethënëse. Diaspora e jonë në Austri është e madhe dhe aktive dhe se gjeneratat e reja janë duke u shkolluar dhe njëkohësisht janë kontribut dhënë edhe për Austrinë. Bashkëpunimi dhe mbështetja nga Austria tha se nuk ka munguar asnjëherë dhe nuk do të mungojë, por është me rëndësi që delegacionet austriake në Këshillin e Evropës dhe në Parlamentin Evropian të japin kontributin e tyre në mbështetje të Kosovës në çështjet e pa përmbyllura për pavarësinë e Kosovës. Ne kemi filluar dhe po vazhdojmë dialogun me Serbinë me ndërmjetësimin e BE dhe aq sa ka mundësi edhe me SHBA dhe do të ishte një kontribut nëse politika e Kosovës dhe e Serbisë do të dakordoheshin me njëra -tjetrën. Serbia dëshiron ta ruajë status quon dhe nuk është e interesuar që të ketë marrëveshje në mes të dy vendeve. z. Haliti vlerësoi se sa më shpejt të përfundojë dialogu, sa më parë që të stabilizohet rajoni i Ballkanit aq më mirë do të jetë edhe për Evropën e bashkuar.

**Time Kadrijaj** i dëshiroi mirëseardhje delegacionit dhe i falënderoi për ndihmën e dhënë Kosovës para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës. Kërkoj nga delegacioni austriak që të llobojnë për Kosovën, në

mënyrë që Kosova t'i arrijë synimet e saja për integrim evropian, sepse Kosova nuk ka alternative tjetër, përkundër Serbisë e cila sa herë që dëshiron i ndërpret bisedimet dhe e kanë alternativë Rusinë dhe Kinën të cilët e mbështesin Serbinë në këto pengesa që po i bëjnë shtetit të Kosovës. Kosova tha se i ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe kërkoi që qytetarëve të saj të mos i mohohet liberalizimi i vizave pasi që është shumë qenësore për qytetarët tanë. Evropa nuk duhet të lejoj diskrepancë në mes të vendeve të Ballkanit që Serbia të merr statusin e vendit kandidat ndërsa Kosova të ngel ende pa liberalizim të vizave. Serbia është duke i shkaktuar pengesa Kosovës duke lobuar për çnjohje nga ato vende që e kanë njohur dhe duke bërë pengesa për mos anëtarësim të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Ne jemi në një fazë të ndjeshme të dialogut dhe me mbështetjen e aleatëve shpresojmë që ky proces të mos shkojë në pafundësi, por të përfundojë me njohje reciproke, në harmoni me Kushtetutën e Kosovës dhe parimet e platformën e saj.

**Dimal Basha**, theksoi se është nder i madh të kemi delegacionin nga Austria këtu, ndihmën e të cilës e vlerësojmë gjatë gjithë historisë, si në konsolidimin e shtetit tonë ashtu edhe në rrugëtimin drejt integritimeve evropiane. Roli i Austrisë ka qenë shumë i madh edhe në rajon, tha z. Basha duke përmendur instalimin e tramvajit në Sarajevë para se ta kishte Vjena një tillë. Sa i përket rrugëtimin drejt BE-së, tha se shumë nga ne kemi jetuar në vende evropiane, ne jemi evropian, dhe ndihemi pjesë e BE-së, por jemi të izoluar nga BE-ja. BE-ja është krijuar duke u bazuar në vlera fundamentale të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave dhe nuk e di si mund të jemi të izoluar dhe t'i promovojmë këto vlera. Evropa nuk i ka përmbush detyrat e saja, ne i kemi përmbushur të gjitha kriteret, jemi gjeneratë e re, e cila do të punojë dhe do ta luftojë korrupsionin. Evropa është rruga më e mirë për ne që të ecim përpara, por ne jemi të injoruar nga Evropa, vlerat e së cilës i kemi përçafuar dhe i ndajmë. Izolimi tha se është një problem shumë i madh për vendin. Ai kërkoi ndihmën e shtetit austriak, duke theksuar se Kosova ka nevojë për ndihmën e saj dhe të gjithë miqve të saj.

**Carmen Jeitler Cincelli**, njoftoi se është Kryetare e grupit të miqësisë Austri – Kosovë, dhe se janë duke e pritur konstituimin e grupit të miqësisë nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që zhvillohen aktivitetet mes tyre. Ajo tha se Kosova ka bërë hapa të mëdha para dhe se Kosova për të është një temë të cilën e ka afër zemrës, pasi që ka respekt të madh për komunitetin e Kosovës në Austri. Diaspora e Kosovës tha se është një pasuri e madhe dhe se shumë njerëz të ri janë kthyer në Kosovë për të rindërtuar shtetin dhe për këtë duhet të krenoheni. Duke iu referuar librit të autorit Pllana, tha se kjo është historia, por nuk është e ardhmja e Kosovës dhe se e kanë të vështirë t'i ndihmojnë Kosovës nëse ajo i mban sytë nga e kaluara, por dialogu është shumë i rëndësishëm. Synimi i tyre tha se është që ta mbështesin Kosovën për të shkuar drejt BE-së, por është e rëndësishme që Qeveria e Kosovës t'i kryej punët e veta, pasi që presin një sinjal se çfarë mund të bëjë Kosova për të ardhmen e saj. Kosova dhe Austria kanë vlera dhe histori të përbashkët dhe e ardhmja duhet të ndërtohet duke e lënë anash historinë, por jo të harrohet ajo.

**Martin Engelberg** tha se nuk duhet lejuar që të trajtohet vetëm tema e luftës, jo të hiqet dorë nga kjo, por në të njëjtën kohë politikanët janë para një dueli, ku në njërin anë duhet të merren me traumat dhe në anën tjetër duhet të sigurohen që këto të mos i vendosin në tavolinën e negociimit për të ardhmen e vendit tuaj. Ai tha se Kosova mund të mbështetet te ndihma e tyre, qoftë për liberalizimin e vizave, qoftë për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, por problemi qëndron te BE-ja, e cila është një organizatë e komplikuar dhe e dobët sa i përket strukturës së saj. Ka vende brenda BE-së që kanë probleme me pakicat e tyre, apo me autonominë e tyre dhe se këto probleme i pasqyrojnë te ju. Një vend si Spanja ka probleme me Kataloninë dhe nuk mund të zgjidhen ato probleme duke iu bllokuar juve. Nëse BE-ja konsideron se ju jeni problemi ngase nuk jeni duke u

pajtuar me ndonjë çështje, atëherë duhet të siguroheni që t'i largoni ato probleme dhe pengesa dhe të kërkonte se cila është zgjidhja. Po ashtu tha se duhet të ketë sanksionime të qarta, kushdo që nuk e ndjek procesin duhet të sanksionohet.

**Haki Abazi**, lidhur me historinë, tha se ne dëshirojmë që këto të mos përsëritën dhe kemi të drejtën që të mbrojmë historinë tonë. Duke iu referuar konfliktit në mes të Izraelit dhe Palestinës tha se konflikti atje është duke vazhduar, por Kosova është në territorin evropian, ku shtetet e Evropës dhe SHBA-të janë bashkuar për t'i ndihmuar Kosovës. Ai më tej shtoi se janë mbi 600 fshatra të fshira nga toka nga ana e Serbisë dhe askush nuk i përmend këto dhe se historia është pjesë e formimit tonë për të ardhmen. Pajtimi tha se nuk është një dhuratë, është ballafaqimi me të kaluarën, dokumentimi i së vërtetës, e cila është një gjë e rëndësishme dhe pjesë e identitetit tonë si shtet dhe si popull për të vazhduar përpara dhe se ne duhet ta largojmë Serbinë si pengesë ndaj progresit tonë për të ardhmen tonë. Ka shumë persona të humbur, ka familje të shumta në Kosovë që janë duke u zgjuar për çdo ditë dhe nuk kanë një vend ku mund t'i vendosin lule familjarëve të tyre, ky kapitull duhet të mbyllet. Ai më tej shtoi se Kosova nuk ka ngecur, se është duke u përpjekur shumë për t'i kryer punët e veta, por i duhet liberalizimi i vizave në mënyrë që t'i ketë mundësitë e njëjta për t'i zhvilluar marrëdhëniet biznesore. Z. Abazi tha se ne nuk mund ta eliminojmë fuqinë e Ruisë nga këtu dhe se qëllim i saj gjeopolitik është qasja në ujërat e nxehta të Adriatikut dhe se kjo paraqet rrezik për sigurinë për këtë pjesë të territorit. Lidhur me Spanjën e Greqinë tha se këto nuk kanë ndonjë arsye për mos ta njohur Kosovën, por ka ende vende të cilat janë duke na mbajtur të izoluar. Ne nuk i dëshirojmë idetë për ndarje në Kosovë, diversiteti etnik, religjioz, racor është i mirëseardhur, por identiteti ynë është evropianë dhe ne duhet të jetojmë dhe festojmë këtë, shtoi z. Abazi. Sa i përket investimeve dhe zhvillimit ekonomik, bëri të ditur se Kosova është duke ecur përpara, se është duke i marrë investimet nga diaspora dhe kërkoi që Austria ta shtyjë përpara zhvillimin ekonomik të Kosovës me njohuritë dhe përvojat që i ka. Aspekt tjetër ku Austria mund ta ndihmojë Kosovën tha se është në luftimin e kërcënimeve të sulmeve kibernetike pasi që mundësitë e Kosovës për t'u mbrojtur në këtë fushë nuk janë në nivelin e duhur. Bëri të ditur se Kuvendi së shpejti do ta formojë grupin e miqësisë Kosovë-Austri dhe falënderoj Austrinë për edukimin e gjeneratave të reja nga fondet austriake për zhvillim.

**Martin Engelberg** njoftoi se në takimin me Fondin Austriak për Zhvillim ka propozuar që të hapen shkolla austriake për trajnime profesionale, pasi që Kosovës i duhen njerëz të shkathët dhe se këtu Austria mund të kontribuojë shumë. Bëri të ditur se kur të kthehet në Vjenë do ta takojë Kancelarin Kurz dhe do ta njoftojë për përshtypjet e tij lidhur me vizitën në Kosovë. Shprehu mendimin se administrata e Presidentit Trump e ka bërë një punë të shkëlqyer, e cila duhet të vlerësohet, por shtoi se duhet të kuptohet sinjali i tyre, kur ata të vijnë këtu dhe thonë se evropianët janë duku ju ndihmuar. Administrata e tyre do të jetë pozitive dhe miqësore, por nuk do ta bëjnë të njëjtën gjë që e ka bërë administrata e Presidentit Trump dhe se çështja e Kosovës është në fushën e Evropës dhe BE-së. Ai tha se Kryeministri dhe Presidenti, do të sfidohen gjatë takimeve të tyre në kryeqytetet evropiane dhe kërkoi që të mos fajësohen, pasi që janë duke u përpjekur që të gjejnë një zgjidhje të mirë për Kosovën.

**Haki Abazi** pyeti se çfarë është zgjidhje e mirë, pasi që po duket se ka një fotografi më të gjerë.

**Martin Engelberg**, duke iu referuar pyetjes se deputetit Abazi tha se, zgjidhje e mirë është kur Kosova gjen sponsor në BE, i cili thotë se unë jam promovuesi i juaj, kur të bindni këdo në këtë territor, i cili ju thotë se si mund të refuzoni atë që është në tavolinë.

**Haki Abazi**, shprehu mendimin se Kryeministri, Presidenti dhe Ministri i Punëve të jashtme e kanë mbështetjen e plotë të parlamentit, duke shtuar se ka edhe vija të kuqe, pasi që me këto vija të kuqe i kanë fituar zgjedhjet. Ai tha se kur ishim në opozitë e kemi kritikuar pozitën për misionet e pamundura duke e nënshkruar demarkacionin me Malin e Zi, duke humbur tokën tonë për të marrë liberalizimin e vizave, të cilin ende nuk e kemi. Pakoja e Ahtisaarit, tha se është një dokument gjithëpërfshirës i krijuar nga një proces ndërkombëtar ku Serbia ka qenë pjesëtare deri në fund, në këtë proces Kosova ka bërë kompromise të cilat janë shumë të dhimbshme. Serbët në Kosovë i kanë të drejtat që minoritetet në shtetet e tjera të Evropës nuk i kanë edhe pse janë më pak se 5% e popullatës. Z. Abazi tha se angazhimi i Koshtunicës, Tadiçit e i Vuçiqit ka qenë dhe është që të largohen në momentet kritike dhe ky është një problem, i cili është duke na mbajtur peng. Serbia nuk është duke u angazhuar sinqerisht për të arritur një ujdi politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai shtoi se ne nuk mund të ndërtojmë perspektiven evropiane të Serbisë, prandaj Brukseli, Berlioni, Vjena, Londra duhet ta kuptojnë këtë, jo për shkak të Kosovës, por shkak të Ballkanit Perëndimor dhe të ardhmes së tij. Duhet të ketë angazhim të qartë të Serbisë për rrugëtimin e tyre drejtë BE-së, por jo duke i shkaktuar dëme shqiptarëve dhe Kosovës dhe duke u viktimizuar. Sa i përket ndarjeve kufitare në vija etnike, tha se dizajnimi i vijave etnike në Kosovë nuk do të jetë një version i pranueshëm, kjo metodë është duke u përdorur për ta mbajtur peng të ardhmen tonë, prandaj puna e Kryeministrit, Presidentit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme është një punë e vështirë, por vendosja e drejtësisë në një paqe të qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor do të jetë në duart e BE-së. Z. Abazi, tha se amerikanët kanë vepruar kur kemi pasur nevojë për ta më 1999, dhe ata kanë qenë garantues të mëdhenj të paqes, por e ardhmja jonë është BE-ja, prandaj dëshirojmë që vendet e BE-së të na ndihmojmë që të mos jemi në kufijtë e tensioneve dhe në mëshirë të Rusisë.

**Carmen Jeitler Cincelli** tha se storjen e Kosovës duhet ta tregoni si storje të inovacionit, të njerëzve të aftë që i keni e që janë të uritur për sukses, por edhe storje të fuqisë suaj, të liderëve tuaj të rinj. Këtë storje tha se do ta promovojmë së bashku, sepse kjo është mënyra më e mirë që Kancelari dhe ministrat tonë në Austri mund të ju mbështesin.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetari i komisionit,

---

Haki Abazi